

ERMAL BAZE**PRAKTIKA TË FEUDALIZMIT VENECIAN
NË ZONËN E SHKODRËS
(fondi i shek. XIV – fillim i shek. XV)**

Më 1392, Republika e Venedikut shtiu në dorë qytetin e Durrësit dhe menjëherë pas tij edhe një varg qytetesh të tjera të bregdetit shqiptar si: Lezhën (1393), Shkodrën e Drishtin (1396), Ulqinin e Tivarin (1405)¹. Rrethanat historike që e lejuan Sinjorinë të shtrihej në Shqipëri, shkaqet dhe interesat që e shtynë atë të ndërmerre një aksion të tillë të fuqishëm janë tashmë të njohura në literaturën historike.

Në këtë punim do të marrim në shqyrtim një problem që e konsiderojmë për arsyet që do të themi më poshtë, të rëndësishëm, aq më tepër kur në historiografinë shqiptare dhe atë të huaj, në përgjithësi, ai nuk është shtruar si objekt studimi më vete. Fjala është për praktika të jetës feudale në zonën e Shkodrës gjatë administrimit venecian, ku jemi përpjekur të japim një kuadër më të plotë në lidhje me llojet e pronësisë mbi tokën, si dhe me pozitën dhe funksionin e përfaqësuesve të pushtetit lokal venecian në trevën e Shkodrës, që prezantohej prej figurës së proniarit, kreut dhe urdhëruesit, dallimeve midis tyre, si dhe ndryshimet që ata pësuan në krahasim me periudhën bizantine.

Për realizimin e këtij punimi, dokumenti kryesor dhe më i plotë është “*Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*”². “Kadastra e Shkodrës dhe Regjistri i Koncesioneve” është hartuar për pronat që Venediku zotëronte në tokat shqiptare dhe për sistemin fiskal të banorëve ndaj autoritetit venecian. Në të ka edhe të dhëna për strukturën dhe llojet e pronës, për historinë social-ekonomike, për format e administrimit, për jetën e brendshme të fshatit etj. Të dhënat

¹ Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas*, Tiranë: 8 Nëntori, 1988, f. 66-67. Luan Malltezi, “Abuzime të aparatit qeveritar në zotërimet e shtetit venedikas në Shqipëri”, në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, vëll. I, Tiranë: 1989, f. 112.

² Injac Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës (1416 – 1417)*, Instituti i Historisë, Tiranë: “Shtypshkronja e Re”, 1977.

që nxirren prej tij, ndonëse të pakta e kryesisht të tërthorta, tregojnë se toka kishte kaluar në pronësi private dhe se ajo shitej e blihej.

Raportet dhe llojet e pronësisë mbi tokën përbëjnë elementin esencial për të njohur nivelin e zhvillimit të marrëdhënieve feudale. Si trashëgim nga e drejta bizantine, toka i përkiste perandorit, kurse gjatë sundimit venecian një grupi të caktuar njerëzish. Në këtë mënyrë, janë përcaktuar detyrimet që popullsia duhet të shlyente ndaj shtetit për prodhimet e ndryshme bujqësore dhe që përbënte rentën qendrore. Gjithashtu, pjesa tjetër e detyrimeve u përkiste individëve të veçantë, përfaqësuesve të kategorisë sociale që ishte në krye të jetës politike e ekonomike lokale.

Një rentë e tillë, e ndarë në dy pjesë, kufizonte të drejtën e pronësisë private mbi tokën³. Mbi këto praktika ishte ngritur dhe pati vepruar institucioni feudal bizantin pronia, që natyrisht shtrihej edhe në viset shqiptare, siç e tregojnë të dhënat e ndryshme burimore të karakterit dokumentar, toponomastik etj., duke pasur impaktin e saj në pronësinë mbi tokën. Por kjo nuk ka gjetur shprehjen e vet në periudhën historike me të cilën ka të bëjë “Kadastru i Shkodrës dhe Regjistri i Koncesioneve”, siç e dëshmojnë të dhënat që mund të nxirren prej këtij dokumenti.

Një ndryshim thelbësor dhe i rëndësishëm që kishte ndodhur me pronian në zonën e Shkodrës gjatë administrimit venecian në krahasim me pronian bizantine ishte trashëgimia e kësaj lloji prone. Pronia në zonën e Shkodrës në pjesën më të madhe të rasteve ishte bërë e trashëgueshme⁴, duke ndryshuar në mënyrë rrënjësore me statusin dhe kushtet e pronies bizantine, pasi pronia në Bizant nuk ishte kurrësi një zotërim me të drejta të plota dhe nuk mund të trashëgohej nga i ati tek i biri në rast se ky nuk merrte përsipër të kryente detyrimin ushtarak, si dhe pa lejen e miratimit të perandorit.

Trashëgimia e pronies gjatë administrimit venecian në trevën e Shkodrës, dëshmon në mënyrë eksplicite se pronia ishte shndërruar

³ Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Tiranë: Botimpex, 2005, f. 29.

⁴ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 78a (fshati i quajtur Turki, proniar i të cilit është burri fisnik zoti Marin Bonçi dhe trashëgimtarët e tij), 80a (fshati i quajtur Gleros i është dhënë në pronia Zuan Anglezit dhe trashëgimtarëve të tij), 84a (fshatrat e quajtur Gostoli dhe Misgoj, të cilat banojnë së bashku, proniar i të cilave është burri fisnik zoti Marin Bonçi dhe trashëgimtarët e tij), 97b, 103a, 103b (fshati i quajtur Prekali nën Shkallë, proniar i të cilit është Jonema Prekali, me vëllezërit e trashëgimtarët e vet), 104a.

gradualisht në një zotërim të pakushtëzuar (*aq sa fjala pronie do të trashëgohej në fjalorin e shqipes, duke marrë kuptimin e çdo forme zotërimi (pronë)*⁵. *Ndonëse fjala pronë rrjedh nga fjala pronie, kjo e fundit ka një kuptim të caktuar historik, kurse termi pronë ka një kuptim më të përgjithshëm*), duke mos pasur më ndonjë ngjashmëri apo lidhje të madhe me pronien në Bizant. Ky ndryshim esencial në lidhje me kushtet dhe gjendjen e pronies mund të shpjegohet me format dhe praktikat e feudalizmit perëndimor, që venecianët i aplikuan dhe i adaptuan në zonën e Shkodrës.

Gjithashtu, një rëndësi të veçantë për të kuptuar shkallën e marrëdhënieve feudale merr problemi nëse toka ka qenë në pronësi private deri në shitblerjen e saj. Pavarësisht, se burimet dokumentare janë të pakta dhe fragmentare, ato vërtetojnë mbi shitblerjen e tokës dhe se kalimi i saj në pronësi private kishte bërë të mundur koncentrimin e tokës në pak duar, duke krijuar një diferencim ekonomik e social në gjirin e popullsisë së asaj kohe.

Në Kadastër janë shënuar një numër relativisht i konsiderueshëm pronash, që kishin kaluar në pronësi të plotë të Republikës së Shën Markut, kryesisht nëpërmjet konfiskimeve që u ishin bërë atyre që ishin ngritur kundër Sinjorisë⁶. Kjo vërehet në sasinë e pronave tokësore, që kanë pasur njerëz të shpronësuar, ku dalin prej tyre individë që zotëronin prona shumë herë më të mëdha në krahasim me të tjerët⁷.

Nga të dhënat e Kadastrës, vërehet qartë prezencën e një kategorie sociale të varfër me fare pak tokë dhe burime ekonomike të pamjaftueshme. Ishte kjo arsyeja që një numër i konsiderueshëm familjesh fshatare dalin të shënuar në Kadastër pa detyrimin e plotë ose të pjesshëm të dukatit e të modit të drithit⁸, që ishte detyrim i çdo familjeje ndaj shtetit venecian.

⁵ Aleks Buda, *Shkrime historike*, vëll. 3, Tiranë: Toena, 2002, f. 39.

⁶ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 2b, 3b, 8b, 9b, 10b, 11b, 12a, 12b, 13a, 13b, 18a, 19a, 20b, 22a, 22b, 23b, 24b, 25a, 26a, 29a, 30b, 31a, 35a, 40a, 40b, 43a, etj.

⁷ *Po aty*, fl. 10a, 11a, 12ab, 20b, 22ab, 24ab, 31a, 40a, 40b, 43a, 61b, 97a, 106b, 171b, etj.

⁸ *Po aty*, fl. 38a, 39a, 39b, 47a, 51b, 52a, 52b, 53b, 56a, 56b, 57a, 58a, 59b, 60a, 64a, 74a, 74b, 75a, 76a, 76b, 84a, 87a, 90a, 91a, 91b, 93b, 104a, 104b, 109b, 111a, 111b.

Familjet e përjashtuara tërësisht ose pjesërisht nga detyrimet kanë qenë familjet që nuk zotëronin fonde tokësore, sepse ishin të obliguar të shlyenin të gjitha detyrimet ndaj Venedikut edhe ata që kishin në pronësinë e tyre sipërfaqe të vogla tokësore. Kështu, p.sh. një banor i fshatit Samrisht, Bogdan Teosllavi⁹ zotëronte 4 dynym e gjysëm tokë personale, ku kishte ngritur në të, shtëpinë dhe kopshtin, si dhe shlyente të gjitha detyrimet ndaj Sinjorisë¹⁰.

Në këtë mënyrë, edhe pse kemi një deficiencë të theksuar burimore, nënkuptohet që familje të varfëra pa tokë jetonin duke shërbyer e punuar në pronat e familjeve të fuqishme nga pikëpamja ekonomike, të cilat në disa raste arrinin në qindra hektarë, siç ishin pronat e konfiskuara të Moisi Vitës¹¹. Akumulimi i pronave të tilla tokësore është bërë kryesisht nëpërmjet shitblerjes së tokës¹². Shitblerja e tokës ishte e zhvilluar dhe e përhapur, aq sa, në kundërshtim me legjislacionin venecian, kishte raste që shiteshin edhe tokat e shtetit venecian prej njerëzve që i kishin marrë ato me qira¹³.

Pronësia private mbi tokën shfaqet në mënyrë eksplicite, ku në fshatra të ndryshëm krahas pronave të banorëve të fshatrave përkatëse, kishte edhe pronarë që nuk ishin banorë të atyre fshatrave¹⁴. Prezenca e pronarëve të tokave, të cilët nuk banonin në ato fshatra ku kishin zotërimet e tyre, dëshmohet edhe nga raste ku janë shënuar njerëzit që mbanin prona të Venedikut pa qenë banorë të atyre fshatrave¹⁵. Gjithashtu, duhet theksuar se pronësia private mbi tokën nuk ekzistonte vetëm tek meshkujt, por edhe tek linja femërore, sidomos tek ajo kategori femrash që ishin vejusha, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve trashëgonin pronën e bashkëshortit të tyre¹⁶.

Kuadri i raporteve dhe i llojeve të pronësisë mbi tokën në zonën e Shkodrës gjatë qeverisjes veneciane, bëhet më i plotë po të marrim në

⁹ *Po aty*, fl. 98b.

¹⁰ *Po aty*, fl. 159b.

¹¹ *Po aty*, fl. 2b, 8b, 9b, 10b, 11b, 20ab, 22b, etj.

¹² K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f. 30.

¹³ *Po aty*, f. 31.

¹⁴ *Kad.*, fl. 40a, 41a, 47a, 48a, 60b, 61ab, 75b, 88a, 102b, 105a, 106b, 148ab, 164ab.

¹⁵ *Po aty*, fl. 140a, 150b.

¹⁶ *Po aty*, fl. 39b, 40a, 44a, 47a, 56b, 75a, 76a, 77a, 85b, 89a, 90a, 96a, 98a, 98b, 103a, 104b, 106b, 109a, 111b.

konsideratë edhe tokat e Kishës, e cila nuk ishte një pronare e madhe tokash e pasurish siç është trajtuar më parë në historiografinë shqiptare¹⁷. Kisha zotëronte një numër normal pronash dhe pasurish¹⁸ në krahasim me pronat tokësore që u përkisnin njerëzve nga shtresat e mesme dhe të larta fshatare. Në regjistrin kadastral konstatojmë fshatra që i përkasin kishës, ku banorët e të cilëve duhej t'i shlyenin asaj të dhjetën, krahas rentës qendrore¹⁹ (*ndaj autoriteteve veneciane*), apo fshatra ku një pjesë e shtëpive të tyre konsideroheshin si “shtëpi të kishës”, pra që i përkisnin asaj²⁰.

Gjithashtu, përveç të ardhurave ekonomike që përmendëm më lart, Kisha siguronte burime financiare edhe si pronare e drejtpërdrejtë tokash e pasurish, të cilat hasen shpesh me emërtimin vreshta e toka buke, të cilësuar si prona të autoriteteve fetare, shkollave apo vëllazërive²¹.

Institucionet e ndryshme fetare, duke trashëguar të drejtën e fituar gjatë sundimit bizantin, ishin kryesisht të përjashtuara nga çdo detyrim ose taksë ndaj Republikës së Shën Markut²², kurse klerikët që zotëronin prona private ishin të detyruar si gjithë të tjerët që t'i paguanin rentën qendrore Sinjorisë²³, pra ata nuk bënë ndonjë përjashtim në krahasim me popullsinë laike. Kjo tregon se përfaqësuesit e institucionit të Kishës nuk gëzonin ndonjë privilegj të madh dhe nuk kishin ndonjë diferencim të dukshëm ekonomik në raport me personat shekullarë.

Gjithashtu, klerikët së bashku me kreun dhe përfaqësuesit e tjerë të fshatit i parashtrorin administratës qendrore veneciane shqetësimet e tyre në lidhje me abuzimet e ndryshme qeveritare. “*Pjetër Gruemiri, plaku apo kreu i fshatit të Gruemirës, Voin Gruemiri, dom Pjetër Grikulku dhe dom Johan Gruemiri, priftërinj të Kishës së Shën Stefanit të Gruemirës, të gjithë burra e banorë të fshatit të Gruemirës së madhe, parashtruan e*

¹⁷ Kasem Biçoku, “Rreth pronësisë së tokës dhe strukturës shoqërore të fshatit shqiptar të zonës së Shkodrës në fillim të shekullit XV”, në *Studime Për Epokën e Skënderbeut*, vëll. 1, Tiranë: 1989, f. 179; Përparime Huta, *Fshati në Sanxhakun e Shkodrës në shekujt XV-XVI*, Tiranë: 8 Nëntori, 1990, f. 128.

¹⁸ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 45a, 144b, 145b, 170b.

¹⁹ *Po aty*, fl. 82b, 96a, 97a.

²⁰ *Po aty*, fl. 90b, 96a, 97a.

²¹ *Po aty*, fl. 6a, 18a, 21ab, 31a, 46ab, 60b, 64b, 80b, 81b, 82ab, 96ab, 110b, 139a, 161b, 167a, 170b.

²² *Po aty*, fl. 46a, 46b, 139a, 161a.

²³ *Po aty*, fl. 45a, 46a, 139a, 142a, 149b, 156a, 168b.

*u lutën, për vete dhe në emër të të gjithë burrave e banuesve të fshatit në fjalë të Gruemirës së Madhe që, meqënëse ata banorë të të thënit fshat të Gruemirës së Madhe vit për vit trazohen dhe shqetësohen shumë nga ata që dërgohen për të kërkuar verën që merret e që duhet paguar prej atyre njerëzve të Gruemirës së Madhe për vreshtat që gjenden në atë fshat të Gruemirës së madhe*²⁴. Sipas Kadastrës në fjalë, klerikët paraqiten si zotërues të vreshtave, arave e pasurive të ndryshme²⁵, të cilat janë të ngjashme dhe kanë pothuajse të njëjtat përmasa dhe madhësi me pronat dhe pasuritë e personave të tjerë laikë.

Për sa i përket pronësisë së përbashkët të bashkësive fshatare, kjo nuk pasqyrohet në Regjistrin Kadastral të Shkodrës, por jepen të dhëna që vërtetojnë se një pjesë e konsiderueshme e pyjeve dhe kullotave kishte kaluar në pronësi të pushtetit venecian²⁶.

Në kushtet e defiçencës burimore për kategoritë e tjera të pronës, njohja e pronave, që kishin kaluar nën zotërimin e drejtpërdrejtë të Sinjorisë, dhe që më parë u përkisnin individëve të veçantë, merr një rëndësi të veçantë edhe për njohjen e formave të dhënies së tyre në përdorim njerëzve të tjerë dhe detyrimet që këto duhet të shlyenin. Këto duhen pranuar si një praktikë e zakonshme që e aplikonin edhe pronarët e mëdhenj feudalë në tokat e tyre, duke u bazuar nëpërmjet formave dhe strategjive që ndiqte në pronat e tij, pushteti venedikas.

Duke iu referuar dokumentacionit të kohës, që ishte “Kadastra e Shkodrës dhe Regjistri i Koncesioneve”, në trevën e Shkodrës gjatë administrimit venecian konstatohen rreth 25 proniarë²⁷. Madje, funksioni i proniarit dokumentohet edhe në qytetin e Shkodrës²⁸. “Në Shkodër, kishte proniarë, të cilët ishin të detyruar të shkonin në ushtri me kalorësi të vet, si herët nën serbët ashtu edhe më vonë nën venecianët”²⁹. Ata do

²⁴ *Po aty*, fl. 138a.

²⁵ *Po aty*, fl. 2a, 10a, 13a, 19b, 22a, 23b, 24a, 25b, 31a, 34b, 40a, 41a, 45a, 46ab, 47b, 60b, 61b, 78b, 80b, 135a, 159a, 160b.

²⁶ *Po aty*, fl. 10ab, 11b, 25ab.

²⁷ *Po aty*, fl. 38a, 38b, 47a, 52a, 53b, 55a, 57a, 59b, 74a, 74b, 78a, 80a, 84a, 86a, 87a, 87b, 91b, 97a (dy fshatra), 97b, 102a, 103a, 103b, 104a, 112a.

²⁸ *Po aty*, fl. 10a, 12a, 138a.

²⁹ Kostandin Jiriçek, “Shkodra e krahina e saj në Mesjetë”, në *Vëzhgime iliro-shqiptare*, vëll. I (përpiluar prej Dr. Ludwig Von Thalloczy-t, përkthyer në shqip nga Mustafa Merlika-Kruja), Shkodër: Camaj-Pipa, 2004, f. 118.

të ishin të pranishëm në qytetin e Shkodrës deri në fund të sundimit venecian³⁰. Pavarësisht se të dhënat dokumentare dëshmojnë për funksionin e proniarit në qytetin e Shkodrës, ato nuk japin ndonjë informacion të rëndësishëm në lidhje me proniet që ata zotëronin brenda juridiksionit të qytetit dhe me emrat e përveçëm të proniarëve³¹. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në qytetin e Shkodrës në fillim të shek. XV, nuk ka ekzistuar institucioni i pronies dhe kategoria e proniarëve, pasi edhe siç shkruhet në parathënien e regjistrit kadastral: “...këto të dhëna dhe akte për institutin e pronias nuk janë objekt i Regjistrit dhe, në qoftë se hyjnë aty, janë të rastësishme”³².

Proniarët e kanë zanafillën e tyre nga organizimi i shtetit bizantin dhe e morën këtë emër nga pronia, që ishte një sasi e caktuar toke e përfaqësuar nga një numër ekonomish fshatare, që perandori bizantin me anë të një diplome të posaçme ua shpërndante personave laikë apo institucioneve fetare për t'i pasur në zotërim të kushtëzuar³³.

Duke marrë pronien, zotëruesi i saj, *proniari*, fitonte të drejtën të vilte nga ekonomitë fshatare që ndodheshin brenda saj një numër të caktuar detyrimesh që deri atëherë shkonin në favor të arkës perandorake³⁴. Në këmbim të kësaj proniari ishte i detyruar t'i përgjigjej thirrjes së perandorit për shërbim ushtarak, duke u paraqitur me një numër kalorësish e këmbësorësh të armatosur me shpenzimet e veta.

Nga këndvështrimi legjislativ, pronia ishte një praktikë pothuajse e njëjtë me ngastrat ushtarake (*stratitotika*), ku të dyja jepeshin në zotërim të kushtëzuar, me kushtin e kryerjes së shërbimit ushtarak. Por nga këndvështrimi social ndryshimi midis tyre ishte i qartë, pasi zotëruesit e ngastrave ushtarake i përkisnin kategorisë së fshatarësisë së lirë, kurse proniarët i përkisnin kategorisë së pronarëve të mëdhenj të tokave, të cilët përdornin punën e bujqve të varur dhe të varfëruar. Proniat lidheshin

³⁰ Injac Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)*, pjesa e parë (1479-1499), Instituti i Historisë, Tiranë: Kombinati Poligrafik, 1979, dok. 22: “1479 qershor 28, Venedik – *Merret vendim për t'u gjetur vendet përkatëse rreth 40 shkodranëve proniarë, që kanë qenë në rrethimin e Shkodrës*”.

³¹ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 206.

³² *Po aty*, f. 4.

³³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI-vitet 20 të shek. XIX), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 253.

³⁴ A. Buda, *Shkrime historike ...*, vëll. 3, f. 39.

ngushtë me personin të cilit i jepeshin; ky e mbante pronien sa kohë që kryente detyrimet e tij dhe pas vdekjes së proniarit, ajo i kthehej përsëri pushtetit qendror dhe me një diplomë të posaçme perandori ia kalonte atë një pronari të ri. Pronia nuk shitej, nuk ndahej, nuk dhurohej dhe nuk mund të trashëgohej nga i ati tek i biri, në rast se ky nuk merrte përsipër të kryente detyrimin ushtarak, si dhe pa lejen e miratimit të perandorit.

Me kalimin e kohës pronia pësoi ndryshime thelbësore, ku në shek. XIII-XIV proniarët fituan një numër të madh privilegjesh e atributesh, duke e zhvendosur gjithnjë e më shumë pushtetin qendror, si dhe sasia e rentës që shkonte në dobi të proniarit u rrit së tepërmi në raport me atë që i shkonte arkës qendrore³⁵. Proniarët filluan të merrnin për vete edhe taksën e tokës, që ishte një atribut i pandashëm i pushtetit qendror, si dhe ngritën një aparat të tyre administrativ, që zëvendësoi atë shtetëror, me nëpunës, roje, ushtarë, dhe pas shek. XIII fitoi edhe të drejtën e gjykimit, që ishte një nga prerogativat kryesore të pushtetit qendror për ushtrimin e sovranitetit³⁶. Në kapërcyell të shek. XIV, pronia po merrte gjithnjë e më shumë tiparet e një zotërimi feudal të pakushtëzuar dhe të pavarur, duke bërë të mundur trashëgimin, ndarjen dhe shitjen e saj.

Institucioni i pronies njohu një përhapje të madhe në zonën e Shkodrës, ku në shekullin XIV dëshmohet një numër i madh proniarësh, të cilët me aprovimin e Venedikut administronin toka, që ishin nën juridiksionin përkundrejt angazhimit ushtarak ndaj kontkapedanit të Shkodrës³⁷. Nga të dhënat burimore del se para pushtimit venecian, në kohën e sundimtarëve vendas të Balshajve, renta mbi popullsinë nxirrej përgjithësisht në formën e një tatimi fikse që ishte i barabartë për çdo familje³⁸.

Republika e Shën Markut, në fillim të instalimit të saj në viset shqiptare, sipas të dhënave të Kadastrës, vendosi detyrimin sipas prodhimit, duke e parë këtë si një ndryshim që nuk do të inspironte pakënaqësinë e kategorive të ndryshme sociale. Ndërsa me sistemin e mëparshëm pjesa e rentës që i detyrohej zotit të vendit, e shprehur me detyrimet fikse, mbledhej nga feudalët e veçantë (proniarë, krerë dhe

³⁵ Petrika Thëngjilli, Selim Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Prishtinë: 2002, f. 29.

³⁶ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 253.

³⁷ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-II-45, Georgy Ostrogorsky, "Pronia në Zetë në kohën e sundimit të Venedikut", fl. 2-3).

³⁸ K. Biçoku, *Për Skënderbeun ...*, f. 48.

urdhërues) dhe i dorëzohej atij, tani, me sistemin tjetër që zbatuan venedikasit, vepra e krerëve dhe e proniarëve në këtë fushë nuk ishte e nevojshme³⁹.

“Sistemi i ri për nxjerrjen e rentës së Sinjorisë solli menjëherë ndër fshatrat disa zyrtarë, që me sistemin e mëparshëm të pronias, nuk njiheshin në vend: për caktimin e rentës që do t’i shkonte Sinjorisë, sundimtari i Shkodrës dërgonte zyrtarë ushtarakë me detyrën që të çmonin ndër ara frytet e korrjeve të ardhshme (extimatores – çmuesit) dhe pastaj, në kohën e korrjeve, dërgonte për të mbledhur të dhjetat (decimatores – dhjetarët)”⁴⁰. Një sistem i tillë për nxjerrjen e rentës së Sinjorisë cenonte pra, veç interesave ekonomike, edhe pozitën sociale e politike të feudalëve vendas.

Por nuk kaluan veçse 2-3 vjet dhe pesha e kësaj shtrese vendase u ndie, sidomos në kryengritjen e përgjithshme që shpërtheu më 1399, aq sa venedikasit u detyruan më në fund t’i drejtoheshin asaj, qoftë për të shtënë në punë përvojën e saj luftarake të fituara në përleshjet e kaluara me turqit, qoftë për të mbajtur të qetë krahinën⁴¹. *“Riaktivizimi i krerëve dhe proniarëve vendas, sidomos në funksionin ushtarak, nisi më 1400 dhe qysh prej kësaj date ata erdhën duke dalë në plan të parë të ngjarjeve të vendit në të gjitha aspektet e veprimtarisë ekonomike, shoqërore dhe politike”⁴².*

* * *

Si proniarë, kryesisht, emëroheshin njerëzit më besnikë të Republikës së Shën Markut, që i shërbenin asaj me përkushtim dhe devotshmëri⁴³. Si përfaqësues të pushtetit lokal venecian, proniarët kishin

³⁹ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 6.

⁴⁰ *Po aty.*

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty.*

⁴³ *Po aty*, fl. 169b (Ne A. Kontareno etj., A. Fuskolo etj., dhe N. Zanthani etj., gjithë atyre të cilëve do t’u bien në dorë këto letra dhe veçan secilit, po u bëjmë të ditur që, duke parë besnikërinë e madhe të Radosklav Romestinjës, të Nikolla Salumes dhe të Vukey Salumes nipit të tij, dhe duke pasur parasysh veprat dhe sjelljet e tyre të mira, dhe meqënëse ata na u lutën që, mbasi paraardhësit e tyre, gjyshërve stërgjyshër, mbanin fshatrat e Zanjevës, Policës dhe Shkurit dhe ishin proniarë të tyre, dhe ato fshatra me të drejtë të pasurisë atërore i mbanin dhe i posedonin, të denjonim atyre lutësve t’ua vërtetonim ato fshatra me kufijtë e tyre –

për detyrë të bindnin dhe të detyronin fshatarët që të zbatonin urdhërat dhe ligjet e autoritetit qendror, të mbikëqyrnin punimin e tokave me qëllim që të mos liheshin djerr, të mbidhnin të gjitha detyrimet fiskale në dobi të shtetit, duke ua dorëzuar të plota rektorëve të Shkodrës ose zyrtarëve të ngarkuar me këtë punë⁴⁴, të merreshin me drejtimin e çështjeve të rëndësishme që i përkisnin fshatit, si dhe në ndonjë rast t'i shërbenin Sinjorisë me forca të armatosura, si këmbësorë dhe kalorës⁴⁵. Proniarët, të cilët angazhoheshin edhe me kryerjen e shërbimit ushtarak ishin njëkohësisht edhe krerë të fshatrave përkatës, siç është rasti i Bolcës⁴⁶, i Balcit⁴⁷ dhe i Podgorës⁴⁸. Kjo, ndoshta, ndodhte për pozitën e konsoliduar dhe autoritare të këtyre përfaqësuesve lokalë të shtetit, të cilët gëzonin si atributet e proniarit ashtu edhe të kreut.

Sipas burimeve të “Kadastrës së Shkodrës 1416 – 1417”, dallimi midis funksionit të proniarit dhe kreut nuk jepet në mënyrë shumë të qartë, por mendohet se proniari ka pasur një pozitë më të privilegjuar dhe më tepër prerogativa se figura e kreut apo e urdhëruesit, çka dëshmohet edhe nga numri i vogël i tyre, ku nga 116 fshatra të regjistruar në regjistër, rezultojnë 25 proniarë. Figura e proniarit duhet të ketë pasur një rëndësi më të madhe politike, ekonomike dhe sociale në hierarkinë feudale të asaj periudhe, në krahasim me ata persona që mbanin postin e kreut dhe të urdhëruesit.

Për besnikërinë dhe shërbimet që tregonin dhe kryenin në favor të Republikës së Venedikut, proniarët gëzonin një sërë privilegjesh, si:

prandaj ne, me anë të këtyre letrave, në fuqi të pushtetit dhe të barrës që na kanë qenë dhënë e lëshuar në këto vise, po ua vërtetojmë në pronia fshatrat e sipërshënuara të Zanjevës, Policës dhe Shkurtit).

⁴⁴ *Po aty*, fl.169b (proniarëve të fshatrave të Zanjevës, Policës dhe të Shkurtit, njerëzit e atyre fshatrave të detyrohen t'u binden atyre Radosklavit, Nikollës dhe Vukeces si proniarë të tyre në çdo gjë që do t'u urdhërojnë atyre dhe që t'i përkasë shtetit dhe nderit dukal. Dhe ata, Radosklavi Nikolla dhe Vukece të detyrohen të nxjerrin të gjitha të hyrat e të ardhurat e atyre fshatrave që i përkasin zotërimit tonë dhe ato t'ua dorëzojnë të plota rektorëve të Shkodrës ose zyrtarëve të ngarkuar për këtë punë), 170a.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 42b, 55a, fl. 57a, fl. 74b, 75a, 76a, 78a, 171a.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 55a.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 57a.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 171a.

përjashtoheshin nga detyrimet fiskale⁴⁹ (*krerët dhe urdhëruesit në ndonjë rast paguanin pjesërisht*⁵⁰, *kurse proniarët në asnjë rast. Ky fakt mund të merret edhe si një ndryshim ose dallim midis figurës së proniarit dhe atij të kreut*), pajiseshin me prona tokësore paraspor⁵¹ (*Pronë tokësore shtetërore që fshatarët detyroheshin ta punonin me punë angari. Në sistemin feudal të zonës së Shkodrës kjo pronë zakonisht u caktohej proniarëve*) dhe dhurata të ndryshme.

Me rastin e hartimit të “Regjistrit Kadastral të Shkodrës” administrata venedikase u orvat të përcaktonte të drejtat dhe atributet e proniarëve, ku u vendos që kur proniarët e fshatrave çojnë e bëjnë paraspor apo e kanë parasporin ndër fshatrat e veta, njerëzit e atyre fshatrave janë të detyruar ta lërojnë atë paraspor, ta mbjellin, e ta punojnë, pa asnjë pagesë⁵², kurdo që t’ia kërkojë proniari i tyre, por proniari është i detyruar t’u japë farën që duhet të mbjellin në atë paraspor⁵³.

Gjithashtu, ata që punonin në pronat e proniarit ishin të detyruar të korrnin, të shkojnë dhe t’i shpien të pastruara ato drithëra të atij paraspori në shtëpinë e proniarit të tyre, pa asnjë shpërblim, kurse proniarët dhe krerët nga ana e tyre janë të obliguar t’ua heqin shpenzimet e tyre personave që do të punojnë. Banorët e fshatit Grizhë ishin të detyruar të lëronin e të mbillnin të njëzet arat paraspor të proniarit e të kreut të fshatit të tyre, kurdo që të kërkonte ai⁵⁴. Po kështu fshatarët e Belanit duhet të lëronin e të mbillnin të shtatë arat paraspor të proniarit Jon Bestole⁵⁵; banorët e fshatit Dajç ishin të detyruar të punonin të katërmbëdhjetë arat që i gëzonte si paraspor Jonema Prekali⁵⁶.

Nga ana tjetër, proniarët ishin të detyruar të jepnin farën që nevojitej për mbjellje në atë paraspor dhe të hiqnin shpenzimet kur ata njerëz

⁴⁹ *Po aty*, fl. 37b, 38a, 38b, 39a, 42b, 47a, 51b, 52a, 52b, 53a, 53b, 54a, 54b, 55a, 57a, 59b, 74a, 78a, 80a, etj.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 38a, 87a, 149b.

⁵¹ *Po aty*, fl. 39b, 62a, 93b, 97b, 102a, 153b.

⁵² *AIH*, A-II-45, G. Ostrogorsky, “Pronia në Zetë...”, fl. 6.

⁵³ K. Biçoku, *Për Skënderbeun ...*, f. 187; I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 170a.

⁵⁴ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 62a.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 102a.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 153b.

punonin parasporin e tyre⁵⁷. Proniarët dhe krerët që nuk zotërojnë paraspor dhe që nuk çojnë për të bërë paraspor mund të nxjerrin vetëm të dhjetën e prodhimit⁵⁸ nga banorët e fshatrave që kishin nën zotërim dhe varësi. Renta në natyrë vilej për të gjitha prodhimet, e cila duket më qartë kur bëhet fjalë për përjashtimin e ushtarakëve nga e drejta për të qenë proniarë dhe krerë fshatrash⁵⁹. Në ndryshim nga proniari dhe kreu, në burimet kadastrale veneciane prerogativa të tilla siç ishte pajisja me paraspor ose vjelja e së dhjetës, nuk dokumentohen për figurën e urdhëruesit, çka dëshmon për disnivelin e pozitës së tij në krahasim me dy të parët.

Statusi i privilegjuar i proniarit si përfitues nga renta kishte bërë që si proniarë të ishin edhe persona të huaj që nuk ishin me banim në fshat⁶⁰, si dhe persona me origjinë joshqiptare, siç ishte rasti i fshatit Gleros, ku si proniar, autoritetet qendrore veneciane kanë caktuar Zuan Anglezin⁶¹. Gjithashtu, duke iu referuar burimeve dokumentare të “Regjistrit Kadastral dhe të Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416 – 1417” dëshmohet se në fshatrat Podgorë⁶², Bolcë⁶³, Balec⁶⁴(qytezë?), Grizhë⁶⁵, Gur i Zi i Rajko Prekalit⁶⁶, Somes⁶⁷, Kukol⁶⁸ dhe Trush i Madh⁶⁹, proniarët kryejnë njëkohësisht edhe funksionin e kreut. “*Burrat që shfaqeshin njëkohësisht si proniarë dhe kryetarë të një fshati, më së shumti kishin pushtet edhe mbi katundet përreth, rrjedhimisht një zonë mjaft të shtrirë ndikimi*”⁷⁰.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 62a, 154a.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 116b.

⁵⁹ *Po aty*, fl. 116a (Në të ardhmen asnjë ushtarak apo burrë arme të mos dhjetojë as të mos japë urdhër për të dhjetuar as për të nxjerrë drithë, verë apo çdo gjë tjetër).

⁶⁰ *Po aty*, fl. 102a.

⁶¹ *Po aty*, fl. 80a.

⁶² *Po aty*, fl. 47a.

⁶³ *Po aty*, fl. 55a.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 57a.

⁶⁵ *Kad.*, fl. 59b.

⁶⁶ *Po aty*, fl. 74b.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 87a.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 91b.

⁶⁹ *Po aty*, fl. 112a.

⁷⁰ Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike (1392 – 1479)*, përkthyer nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2007, f. 171.

Kjo mund të shpjegohet me fuqinë ekonomike dhe politike të këtyre pronarëve, si dhe me kredibilitetin dhe ndikimin e tyre relativisht të madh social, në fshatrat e lartpërmendur. Në Kadastrën veneciane të Shkodrës ekzistojnë edhe raste sporadike, si në fshatin Podgorë⁷¹ dhe Sigjeç⁷² proniarë dhe krerë të të cilit janë vëllezër; në fshatin Polica e Shkurti⁷³ dhe Bolca⁷⁴ si proniarë dalin persona të një familjeje (*xhaxhai me nipin*); në fshatin Zanjeva⁷⁵ rezultojnë tre proniarë të ndryshëm, kurse fshatrat Musanthi dhe Grampsi administrohen nga një proniar i vetëm⁷⁶.

Një ndryshim thelbësor dhe i rëndësishëm që kishte ndodhur me figurën e proniarit në zonën e Shkodrës gjatë administrimit venecian në krahasim me proniarin bizantin ishte trashëgimia e postit të proniarit. Titulli i proniarit në zonën e Shkodrës në pjesën më të madhe të rasteve ishte bërë i trashëgueshëm⁷⁷, duke ndryshuar në mënyrë rrënjësore me statusin dhe kushtet e proniarit bizantin, pasi pronia në Bizant nuk ishte kurrësi një zotërim me të drejta të plota dhe nuk mund të trashëgohej nga i ati tek i biri në rast se ky nuk merrte përsipër të kryente detyrimin ushtarak, si dhe pa lejen e miratimit të perandorit.

Trashëgimia e pronies dhe e postit të proniarit gjatë sundimit venecian në trevën e Shkodrës, dëshmon në mënyrë të qartë se pronia ishte shndërruar gradualisht në një zotërim të pakushtëzuar, dhe se proniari gjithnjë e më tepër po kishte një varësi nominale nga pushteti qendror.

Gjithashtu, një ndryshim tjetër ndërmjet proniarit në zonën e Shkodrës dhe atij bizantin në fillim të shek. XV, vërehej edhe tek kryerja e shërbimit ushtarak në favor të pushtetit qendror. Sipas “Kadastrës së Shkodrës 1416 – 1417”, vetëm një numër i kufizuar proniarësh ishin të angazhuar në kryerjen e shërbimit ushtarak⁷⁸, kurse pjesa më e madhe e tyre nuk kushtëzohej nga një gjë e tillë. Madje, duhet theksuar se autoritetet veneciane në vitin 1416 nxorën një urdhëresë ku ndalohej çdo ushtarak që të merrte apo të kryente funksionin e proniarit. “*Të dalluarit*

⁷¹ I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 47a.

⁷² *Po aty*, fl. 87b.

⁷³ *Po aty*, fl. 53b.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 55a.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 52a.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 97a.

⁷⁷ *Po aty*, fl. 78a, 80a, 84a, 97b, 103a, 103b, 104a.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 55a, 57a, 74b, 78a, 171a.

dhe të nderuarit burra, zoti Alban Kontarini, i nderuar kont – kapidan (administrator i çështjeve civile dhe komandant i forcave ushtarake në zotërimet e Venedikut) i Shkodrës, zoti Andrea Foskolo, i nderuar ambasador e proveditor në viset e Shqipërisë dhe zoti Nikolla Zanthani, i nderuar dhomtar i Shkodrës, që të tre njëzëri, duke zbatuar letrat dukale të vendosura në këshillin e pregadëve (senati) dhe të lëshuara në pallatin dukal ditën e 12 shtatorit, indikcion i dhjetë, 1416, urdhërojnë se tani e tutje asnjë ushtarak dhe asnjë burrë arme të mos jetë as proniar dhe as krye fshati, dhe as mos të kenë asnjë fshat nën vetë⁷⁹. Ky fakt është një dallim i dukshëm, për ndryshimin esencial të statusit dhe funksionit të proniarit në zonën e Shkodrës gjatë sundimit venecian, në krahasim me statusin e proniarit bizantin, sepse kryerja e shërbimit ushtarak ishte një ndër obligimet kryesore që kishin pronarët ndaj pushtetit qendror⁸⁰.

Pavarësisht, se në kapërcyell të shek. XIV pronia në territoret e Perandorisë Bizantine po merrte gjithnjë e më shumë tiparet e një zotërimi feudal të pakushtëzuar dhe të pavarur, duke bërë të mundur trashëgimin, ndarjen dhe shitjen e saj, në fund të shek. XIV dhe fillim të shek. XV, në prag të invazionit osman, vihet re një rigjallërim i institucionit të tokave ushtarake, qoftë në formën e mirëfilltë feudale të pronias, por sidomos në formën e vjetër të parcelave të vogla ushtarake të periudhës së perandorëve maqedonë (shek. IX – XI)⁸¹.

Nga sa trajtuam edhe më lart, mund të arrijmë në përfundimin se proniari në zonën e Shkodrës nuk kishte ndonjë lidhje dhe ngjashmëri të madhe me proniarin bizantin, dhe se ky ndryshim mund të shpjegohet me praktikën e feudalizmit perëndimor, që sollën dhe aplikuan venecianët në viset shqiptare.

* * *

Niveli i zhvillimit të marrëdhënieve feudale në Shqipëri gjatë shek. XV, dëshmon në mënyrë eksplicite për përmbajtjen dhe statusin që kishte marrë figura e kreut. Funksioni i kreut është trashëguar që nga koha e bashkësisë fshatare autonome, kur ai nuk kishte të drejtën e përvetësimit të rentës. Në mënyrë graduale në shekullin XV funksioni i kreut kishte

⁷⁹ *Po aty*, fl. 116a.

⁸⁰ P. Thëngjilli, S. Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine ...*, f. 26.

⁸¹ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 254.

ndryshuar, duke u feudalizuar dhe duke mos pasur ndonjë dallim thelbësor me proniarin. Sipas Kadastrës veneciane të viteve 1416 – 1417, në zonën e Shkodrës figurojnë 65 krerë⁸² dhe 21 urdhërues⁸³.

Krerët dhe urdhëruesit caktoheshin nga radhët e njerëzve besnikë⁸⁴, që kishte administrata qendrore veneciane në fshatrat e trevës së Shkodrës, por gjithashtu nuk mungonin edhe krerë me origjinë të huaj⁸⁵. Gjithashtu, duhet theksuar se në burimet dokumentare të “Regjistrit Kadastral dhe të Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416 – 1417” evidentohen edhe raste të tilla, ku funksionin e kreut e ka pasur abati i fshatit, siç është rasti i fshatit Shirq⁸⁶, si dhe kur figura e urdhëruesit caktohet ose vendoset nga autoritetet lokale fetare, dhe më konkretisht nga abati i fshatit⁸⁷. Një burim i tillë dokumentar nuk ekziston për figurën e kreut apo të proniarit, çka tregon për një pozitë më të lartë dhe më të rëndësishme të tyre në raport me statusin e urdhëruesit.

Funksioni dhe detyrat e kreut dhe të urdhëruesit në zonën e Shkodrës gjatë sundimit venecian nuk kishin ndonjë ndryshim të madh me ato të proniarit. Ashtu si proniarët, edhe krerët dhe urdhëruesit kishin për detyrë të bindnin dhe të detyronin fshatarët që të bënin punë angari në dobi të Sinjorisë, të zbatonin urdhrat dhe ligjet e autoritetit qendror, të mblihdnin të gjitha detyrimet fiskale në dobi të shtetit, duke ua dorëzuar

⁸² I. Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve ...*, fl. 37b, 38b, 39a, 42b, 43b, 44a, 46a, 47a, 50a, 51b, 52a, 52b, 53a, 53b, 54a, 54b, 55a, 56a, 57a, 59b, 74b, 75a, 75b, 76a, 77a, 77b, 79a, 87a, 88b, 89a, 89b, 91a, 91b, 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b, 95a, 95b, 98a, 99a, 103a, 103b, 104b, 108b, 109b, 110a, 110b, 111a, 111b, 112a, 113b.

⁸³ *Po aty*, fl. 37b, 38a, 39a, 44a, 47a, 53b, 57a, 59b, 74a, 78a, 80a, 84a, 85a, 85b, 87a, 89b, 91a, 93b, 97b, 103a, 109a.

⁸⁴ *Po aty*, fl. 145b, 147b, 149a, 151b (Në A. Kontareno etj., A. Fuskolo etj., dhe N. Zanthani etj. Në njëren prej këtyre emërimeve thuhej: "Gjithë atyre të cilëve do t'u bien në dorë këto letra, dhe veçan secilit, po u bëjmë të ditur se, duke marrë parasysh besnikërinë e madhe dhe ndershmërinë e sprovuar, ashtu edhe aftësinë e burrit të matur Johan Somës, nga fshati Gazull, në saje të të cilave ai është për t'u pasur shumë në konsideratë dhe ne duke pasur parasysh se në fshatin e Gazullit nuk gjendet asnjëri më i aftë, përveç të sipërthënit Jon Somës, prandaj po e emërojmë atë urdhërues të fshatit të sipërthënë), 152b, 153a, 156b.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 39a, 44a. 163b.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 96a. *Po aty*, fl. 38b, 39b, 43b, , 149b, 151b, 152a.

⁸⁷ *Po aty*, fl. 157b.

të plota rektorëve të Shkodrës ose zyrtarëve të ngarkuar me këtë punë⁸⁸, si dhe të ingranoheshin me drejtimin e çështjeve të rëndësishme që i përkisnin fshatit. “*Të sipërthënit vëllezër Andrea e Jon Zupani dhe Pal Linthi, që të tre së bashku dhe njëherësh, po i bëjmë krerë të fshatit të Zupanit në mënyrë që, sikundër më parë, të bëjnë në mënyrë që njerëzit e fshatit në fjalë të detyrohen të punojnë e të çojnë për të punuar të gjitha arat e zotërimit tonë dhe secilën prej tyre, që gjenden në fshatin e thënë dhe t`u japin urdhërat që u duhen dhënë njerëzve të atij fshati nga ana e rektorëve që kohë më kohë do të gjenden në Shkodër. Për më tepër, të detyrohen të nxjerrin nga njerëzit e fshatit në fjalë të gjitha të ardhurat që i përkasin zotërimit dukal dhe ato të ardhura t`ua dorëzojnë rektorëve apo zyrtarëve që ngarkohen për këtë punë*”⁸⁹. “*Urdhëruesi i fshatit Gazull duhet të nxjerrë nga banorët e këtij fshati të gjitha rentat e të ardhurat që i përkasin Sinjorisë, dhe ato të ardhura t`ua dorëzojë rektorëve të Shkodrës ose zyrtarëve që ngarkohen për këtë punë*”⁹⁰.

Gjithashtu, në burimet kadastrale veneciane për zonën e Shkodrës përmenden edhe krerë fshatrash, të cilët duhet të organizonin mobilizimin ushtarak në favor të Sinjorisë⁹¹. Një gjë e tillë nuk dokumentohet për figurën e urdhëruesit, çka dëshmon në mënyrë të qartë për pozitën dhe statusin e tij më të ulët në krahasim me atë të kreut.

Funksioni i kreut kishte një status më të privilegjuar politik, ekonomik dhe shoqëror në raport me funksionin e urdhëruesit. Përveç këtyre funksioneve që përmendëm më lart, krerët dhe urdhëruesit si përfaqësues të pushtetit lokal, duhet t`i raportonin Sinjorisë për abuzimet që bëheshin me taksat e fshatarëve, si dhe duhet të tregoheshin të kujdesshëm dhe të drejtë që ndonjë familje fshatare të mos rëndohej me detyrime të tepërta⁹².

Si përfaqësues të pushtetit lokal venecian, si dhe për besnikërinë dhe shërbimet që tregonin dhe kryenin në favor të Republikës së Shën Markut, ashtu si proniarët edhe krerët e urdhëruesit gëzonin një sërë privilegjesh dhe atributësh, ku në pjesën më të madhe të rasteve ishin të

⁸⁸ *Po aty*, fl. 38b, 39b, 43b, , 149b, 151b, 152a.

⁸⁹ *Kad.*, fl. 149ab.

⁹⁰ *Po aty*, fl. 151b.

⁹¹ *Po aty*, fl. 42b, 45a, 55a, fl. 57a, fl. 74b, 75a, 76a.

⁹² *Po aty*, fl. 45b, 138a.

përrjashtuar nga shlyerja e detyrimeve fiskale⁹³ dhe një pjesë e krerëve pajiseshin me prona tokësore paraspor⁹⁴ dhe me dhurata të ndryshme.

Gjithashtu në “Regjistrin Kadastral dhe të Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416 – 1417” nuk mungojnë edhe rastet kur disa krerë dhe urdhërues paguajnë pjesërisht detyrimet në dobi të administratës tatimore veneciane⁹⁵. Ky fenomen ndoshta është i lidhur me pozitën dhe statusin akoma të pakonsoliduar të këtyre krerëve dhe urdhëruesve, si dhe me garantimin dhe sigurimin e Sinjorisë ndaj tyre.

Kjo ilustron më së miri në citimin e mëposhtëm:

“Të sipërthënit vëllezër Andrea e Jon Zupani dhe Pal Linthi, që të tre së bashku dhe njëherësh, po i bëjnë krerë të fshatit të Zupanit në mënyrë që, sikundër më parë, të bëjnë në mënyrë që njerëzit e fshatit në fjalë të detyrohen të punojnë e të çojnë për të punuar të gjitha arat e zotërimit tonë dhe secilën prej tyre, që gjenden në fshatin e thënë dhe t’u japin urdhërat që u duhen dhënë njerëzve të atij fshati nga ana e rektorëve që kohë më kohë do të gjenden në Shkodër. Për më tepër, të detyrohen të nxjerrin nga njerëzit e fshatit në fjalë të gjitha të ardhurat që i përkasin zotërimit duka dhe ato të ardhura t’ua dorëzojnë rektorëve apo zyrtarëve që ngarkohen për këtë punë. Dhe, që të kenë shkak për të vepruar mirë, duam që ata të tre, Andrea, Joni dhe Pali të paguajnë që të tre së bashku vetëm një dukat dhe një mod grurë në vit”⁹⁶.

Në bazë të burimeve të “Kadastrës së Shkodrës dhe Regjistrit të Koncesioneve 1416 – 1417” rezulton, se funksioni i kreut ashtu si edhe posti i proniarit në disa raste ishte bërë i trashëgueshëm⁹⁷, kurse për funksionin e urdhëruesit nuk konstatohet një gjë e tillë. Kjo lidhet më faktin se, si proniari ashtu edhe kreu në mënyrë graduale po e konsolidonin më tepër autonominë dhe pozitën e tyre ekonomike, politike dhe shoqërore përkundrejt pushtetit qendror venecian, ndërsa figura e urdhëruesit nuk e kishte arritur akoma këtë status social - politik, prandaj qëndron edhe në vendin e fundit të hierarkisë feudale të asaj periudhe.

⁹³ *Po aty*, fl. 37b, 38b, 39a, 42b, 43b, 44a, 46a, 47a, 50a, 51b, 52a, 53a, 53b, 54a, 54b, 55a, 56a, 57a, 59b, 74b, 75a, 75b, 76a, 77b, 78a, 79a, 80a, 84a, 85a, 85b, 88b, 89a, 89b, 91a, 91b, 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b, 95a, 95b, 98a, 99a, 103a, 103b, 104b, 108b, 109a, 109b, 110a, 110b, 111a, 111b, 112a, 113b.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 39b, 45b, 62a, 93b, 102a.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 38a, 52b, 77a, 87a, 108b, 149b.

⁹⁶ *Kad.*, fl. 149b.

⁹⁷ *Po aty*, fl. 52b, 54a.

Gjithashtu, në zonën e Shkodrës gjatë administrimit venecian, ekzistojnë edhe raste kur një fshat drejtohet nga dy ose tre krerë⁹⁸, si dhe fshatra që kanë edhe krerë dhe urdhërues, por që janë persona të ndryshëm⁹⁹ dhe jo i njëjti person, siç ishin disa proniarë që kryenin njëkohësisht edhe funksionin e kreut¹⁰⁰. Kjo mund të kuptohet me faktin se pushteti dhe ndikimi i Republikës së Venedikut nuk ishte i njëtrajtshëm dhe efektiv në të gjitha fshatrat e viseve të Shkodrës, pasi jo të gjithë fshatrat e njohën dhe e pranuan sovranitetin venecian pa kontestime dhe forma të ndryshme qëndrese, madje duke arritur në disa raste edhe në kryengritje të armatosura¹⁰¹.

Si përfundim, shqyrtimi analitik e tërësor i të dhënave burimore nga “Regjistri Kadastral i Shkodrës” në punimin tonë, tregon se si pasojë e ndikimit të feudalizmit perëndimor të aplikuar nga venecianët në zonën e Shkodrës, marrëdhëniet agrare ishin zhvilluar në një shkallë relativisht të lartë.

S u m m a r y

THE FEUDALISM PRACTICES IN THE VENETIAN AREA OF SHKODRA (END OF XIV CENTURY – BEGINNING OF XV CENTURY)

Ottoman occupation of Albanian lands favoured intentions of Republic of San Marco to install their rule over some coastal towns with which had long time relations and merchant links. In this regard, the Republic of Venetia captured town of Durrës, progressing afterwards with other coastal towns as: Lezha (1393), Shkodra and Drisht (1396), then Ulqin and Tivar (1405).

⁹⁸ *Kad.*, fl. 51b, 52b, 108b.

⁹⁹ *Po aty*, fl. 38a, 39a, 47a, 57a, 59b, 87a, 89b, 91a, 93b.

¹⁰⁰ *Po aty*, fl. 47a, 55a, 57a, 59b, 74b, 87a, 91b, 112a.

¹⁰¹ *Po aty*, f. 6; Pranvera Bogdani, “Lufta kundër Venedikut për çlirimin e krahinës së Shkodrës dhe qyteteve të saj në fund të vitit 1404 – mesi i vitit 1405”, në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, 2, Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f. 197; Luan Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV”, në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, 2, Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f. 179; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 327.

Venetian Signoria (Lordship) aspired expanding in all these towns with potentially large interests to raise profits and incomes not only through trade, but land ownership by employing new feudal practices as seen on Shkodra region.

As inherited tradition of Byzantium law, land belonged to Sovereign, be it individual (emperor or king) or collective (in this case Venetian Republic). This is how duties were imposed on population by the central ruler in payments of agricultural products which represented a part of levy for the state. Other part of feudal duties belonged to specific individuals – representatives of top social class in local economic and political life.

On these forms of duties has been raised and acted Byzantium feudal institution known as Pronia, which became modified because of Western feudalism practiced from Venetian in Shkodra region, sustaining significant changes making it an inherited and unconditioned property. In 15th century, pronia in area of Shkodra had no resemblance or association to Byzantium pronia.

Venetian authorities used services of local feudal classes administering its properties represented by landlord, chief and commander. In discrepancy to Byzantium landlord, his position in Shkodra region during Venetian rule had become mostly inherited and unconditioned by military service. Agrarian affairs were highly developed in Shkodra region as the consequence of Western feudalism applied by Venetian.

